



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2021

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: ALBA KONSTRUKSION shpk

Adresa: Rruga Frederik Shiroka, Pallati I ri , Shkalla B, Kati 2, Tiranë

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-88397-02-25-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme,  çmimi më i ulët

\* \* \*

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Ed Konstruksion shpk me NIPT K61625001I, vlera 151,017,194 lekë pa tvsh
2. Alba Konstruksion shpk me NIPT J61812013R, vlera 151,463,880 lekë pa tvsh
3. PE – VLA – KU shpk me NIPT K61716013M, vlera 151,981,721 lekë pa tvsh
4. AGI KONS shpk me NIPT K21622001M, vlera ka ofertuar me dy vlera të ndryshme

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Ed Konstruksion shpk
2. PE – VLA – KU shpk
3. AGI KONS shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ed Konstruksion shpk
  - Ne piken 2.3.7. kërkohet se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton asnjë dokument i vlefshëm për plotësimin e kriterit të mësipërm.

- Në pikën 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton asnjë dokument i vlefshëm për plotësimin e kriterit të mësipërm.

- Në pikën 2.3.4 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk është paraqitur dokument i vlefshëm për 1 (një) Inxhinier Mekanik (pika 2.3.4.1) dhe për 1 (një) Ekspert Zjarrfikës (pika 2.3.4.3).

Për plotësimin e kriterit të pikës 2.3.4.4 nuk është paraqitur asnjë dokument.

- Në pikën 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm, i cili duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Gusht – Dhjetor 2020 dhe Janar 2021.

Nuk është paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kriterit të mësipërm.

- Në pikën 2.3.6 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk është paraqitur dokumentacion për 1 (një) asfaltshtruese; 1 (një) autobitumatriçe; 1 (një) rrul; 1 (një) autobot uji; 3 (tre) motogjenerator/ gjenerator, 1 (një) motosaldatrice/saldatrice, 3 (tre) aparatura për bashkim tubacionesh me metoden "Elektro Fusion Joint", 3 (tre) tokmak, 1 (një) matrapik, 2 (dy) sistem eëllpoint/ekuivalent për heqje ujrash, 1 (një) frezë asfalti, 1 (një) sharrë asfalti, 1 (një) sondë për shpime horizontale për kalim tubash nën trasenë e rrugës, 1 (një) sondë për shpime vertikale për kalim tubash nën trasenë e rrugës, 1 (një) aparaturë me ultratinguj për testim/matjen e rrjedhjes ose prurjes.

## 2. PE – VLA – KU shpk

- Në pikën 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Afati i përlogaritjes së kontratave të ngjashme të vlefshme është tre vite nga data e hapjes së ofertave domethene 30.03.2018 deri 29.03.2021.

Nga ana juaj eshte paraqitur kontrata me objekt "Ekzekutimi i fazës së dytë të përpunimit të ujit të pijshës, Linjës së ujit Anadrin dhe kanali derivues I Bazenit Radoniqi." Referuar dokumentit me titull procesverbali i Radoniqit i legalizuar, fillimi I punimeve është me datë 18.11.2015 dhe kanë përfunduar me datë 10.04.2017. Realizimi i kësaj kontrate është më i hershëm se tre vite nga data e hapjes se ofertave.

- Ne piken 2.3.7. kerkohet se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit.

Për të plotësuar kërkesën e mësipërme nuk është paraqitur asnjë kontratë bashkëpunimi/furnizimi paraprake e vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

- Në Pikën 2.3.3 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit për mesatarisht 100 (njëqind) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Gusht – Dhjetor 2020 dhe Janar 2021, lëshuar nga Administrata Tatimore.

Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik nuk përmbush numrin mesatar të punonjësve të kërkuar.

### 3. AGI KONS shpk

- Në pikën 2.3.1 për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Afati I përllogaritjes së kontratave të ngjashme të vlefshme është tre vite nga data e hapjes së ofertave domethënë 30.03.2018 deri 29.03.2021.

Nga ana juaj është paraqitur kontrata me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të furnizimit me ujë të Qytetit Konispol" me vlerë të realizuar të kontratës bazë 186,901,165 lekë me tvsh, afati 05.12.2016 – 28.02.2018. Kjo kontratë është realizuar jashtë tre viteve të fundit, prandaj konsiderohet e pavlefshme si kontratë e ngjashme.

Është paraqitur gjithashtu kontrata shtesë me të njejtin objekt "Rikonstruksion i rrjetit të furnizimit me ujë të Qytetit Konispol" me vlerë të realizuar të kontratës 37,328,467 lekë me tvsh, afati 26.10.2018 – 25.01.2019. Kjo kontrate nuk përmbush kërkesat e pikes 2.3.1 si ne rastin e nje kontrate te vetme me vlere sa 50% e fondit limit.

- Në piken 2.2.3. kërkohet se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020.

Gjate vitit 2020 shoqëria AGI KONS shpk ka kryer aktivitet ne Bashkine Kamez, referuar kontrates me objekt "Rindërtimi i një godinë të re me 2-4 kate mbi tokë kryhen në objektin shkolla 9-vjecare "Halit Coka" Njësia Administrative Bathore, Bashkia Kamëz" e lidhur me date 09.06.2020. Duke qenë se është kryer aktivitet në territorin e Bashkisë Kamëz, keni patur detyrimin ligjor të bënin shlyerjen e taksave për këtë vit, pranë kësaj bashkie, fakt i cilin nuk vertetohet me asnjë dokument.

- Në pikën 2.3.7. kërkohet se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit.

Për të plotësuar kërkesën e mësipërme nuk është paraqitur asnjë kontratë bashkëpunimi/furnizimi paraprake e vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

- Në pikën 2/a të DST kërkohet përshkrimi I ofertës sipas shtojcës 1, ndërkohë nga shqyrtimi I dokumentacionit rezultoi se shoqëria AGI KONS shpk ka paraqitur dy oferta ekonomike të ndryshme për të njëjtin objekt, respektivisht me vlerë 141,776,780 lekë pa tvsh dhe me vlerë 115,167,567 pa tvsh.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Alba Konstruksion shpk me NIPT J61812013R me adrese Rruga Frederik Shiroka, Pallati I ri ,Shkalla B, Kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 151,463,880 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.04.2021

Ankesa: Nuk ka patur

Kryetari

**Redjan KRALI**